



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 15.05.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 09.05.2023.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin prill 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në Digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës”, të shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.)”.
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018.
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 226, datë 26.10.2018.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “RENGY TRADING GROUP” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018.
7. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kW”, i ndryshuar.
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.03.2023 “Mbi licencimin e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Shutri 1” me kapacitet të instaluar 370 kW dhe “Shutri 2” me kapacitet 1600 kW, me kapacitet total të instaluar 1970 kW.
9. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.02.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kW, Hec “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kW dhe Hec “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kW, me kapacitet total të instaluar 4755 kW”, i ndryshuar.
10. Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2023.